



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Qytetërim i Gjuhës B (2)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 30 leksione / 10 seminare
Viti / Semestri : Viti II ,semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme lëndore: Të formojë një gjykim personal, racional dhe aktiv mbi momentet thelbësore të kulturës italiane. Të dijë si të analizojë në mënyrë kritike proceset e historisë italiane në periudhën e referimit. Të njohë proceset historike; të bëjë lidhje midis fakteve shoqërore, historisë së artit dhe kulturës dhe rolit të luajtur nga individë të veçantë

Objektivat specifikë lëndorë:

- 1.Kompetenca gjuhësore: aftësi për të komunikuar me gojë dhe me shkrim me anë të terminologjisë specifike themelore të periudhës artistike të referimit.
- 2.Kompetenca ndërkulturore: aftësi për të njohur proceset historiko-kulturore të periudhës së referimit.
- 3.Kompetenca artistike: aftësi për të përshkruar veprat artistike në një mënyrë analitike duke përdorur terminologjinë specifike.

Rezultate të pritshme:

Studenti duhet:

- 1.Të dijë të njohë, të analizojë dhe të interpretojë veprat artistike të periudhës referuese në fushën e arteve figurative.
- 2.Të dijë të bëjë përshkrime analitike të veprave artistike të trajtuara gjatë kursit
- 3.Të dijë si të krahasojë fenomenet, punimet dhe autorët duke kapur veçoritë, ndryshimet dhe tiparet e përbashkëta